



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 401/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Fatjona Bekteshi, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS) me seli në Graçanicë, paraqitura kundër rrjetit MTS DOO në Kosovë dhe subjektit politik Lista Serbe (LS) me seli në Mitrovicë të Veriut, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore – përmes dërgimit të sms-ve, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës, të mbajtura më 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHEN** të pasafatshme ankesat Anr.401/2019 dhe Anr.402/2019 të datës 07.11.2019, të parashtruara nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore - përmes dërgimit të sms-ve, gjatë ditës së votimit, me datë 06.10.2019.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar ankesat Anr.401/2019 dhe Anr.402/2019 me datë 07.11.2019, të parashtruara nga subjekti politik Samostalna Liberalna Stranka (SLS), me seli në Graçanicë, në të cilat theksojnë se me datë 06.10.2019, të gjithë përdoruesve të rrjetit MTS DOO në Kosovë, i janë dërguar sms me qëllim të ndikimit tek votuesit dhe kështu duke shkelur rregullën zgjedhore Nr.11/2013 përkatësisht nenin 7 të kësaj rregulle. Me këtë mesazh, kompania MTS DOO dhe Lista Serbe gjatë ditës së zgjedhjeve kanë ndikuar drejtpërdrejt tek votuesit. Si provë për pretendimet e tyre parashtruesi ankesave në fjalë i ka bashkangjitur sms-at (me foto) e pretenduar se janë dërguar gjatë ditës së votimit me datë 06.10.2019.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartëcekura dhe i trajton si një ankesë të evidentuar me Anr 401/2019, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesave, gjeti se:

### Ankesat janë të pasafatshme

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit

dhe se të njëjtat janë paraqitur pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 119 paragrafi 1 i LZP-së ku përcaktohet se " *Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqesë ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit, dhe PZAP-i, do të vendosë për ankesën brenda 72 orëve nga koha kur është pranuar ankesa*", si dhe neni 5 paragrafi 5 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Rregullën Nr. 02/2015, ku përcaktohet: "*Për të gjitha çështjet që nuk lidhen drejtëpërdrejt me votimin dhe numërimin, ankesa duhet të parashtrihen pranë PZAP-it, brenda njëzetekatër (24) orëve nga shkelja e supozuar*"

Në rastin konkret ankesat janë dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i tyre me datë 07.11.2019, dhe se nga përmbajtja e ankesave rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi ndërlidhen me thyerjen e heshtjes zgjedhore, në ditën e votimit me datë 06.10.2019.

Nga kjo rezulton se ankesat e lartpërmendura janë dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjor për të parashtruar ankesë në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesave ka qenë me datën 07.10.2019 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesi ankesat i ka parashtruar në PZAP me datë 07.11.2019, që do të thotë se ankesat janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.5 të Rregullores Nr. 02/2015, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart në kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 401/2019 më datën 08.11.2019

**Kryesuesi i Panelit**

Rrustem Thaqi



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.